



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**

**Plani i punës së Komisionit për 2018**

23.01.2018  
Prishtinë

Kryetare e Komisionit

Sala Berisha-Shala

## **Hyrje**

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe praktikës së punës së Komisioneve Parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal (tutje Komisioni) ka hartuar planin e aktiviteteve për vitin 2018. Plani i punës së Komisionit mund të ndryshoj sipas nevojës dhe aktiviteteve të Komisionit.

Komisioni gjatë vitit 2018 si aktivitete kryesore do t'i ketë shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjeve, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe monitorimin e resorëve të Qeverisë që bien në fushëveprimin e Komisionit, mbikëqyrjen e Agjencioneve të pavarura të fushëveprimit të Komisionit, trajtimin e çështjeve në përmirsimin e mjedisit biznesor, mbikëqyrjen e shpenzimeve publike të Ministrive të linjës dhe Agjencioneve të pavarura, mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit/Kuvendit. Komisioni do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, do të angazhojë ekspert dhe do të bashkëpunojë ngushtë me organizatat joqeveritare vendore e ndërkombëtare nga fusha e ekonomisë, infrastrukturës, tregtisë, industrisë etj.

<b><u>Anëtarët e Komisionit:</u></b>	<b><u>Njësia mbështetëse e Komisionit:</u></b>
<b>Sala BERISHA-SHALA</b> Kryetare e Komisionit	<b>Armend Ademaj,</b> Koordinator i Komisionit
<b>Dardan SEJDIU</b> Zëvendëskryetar i parë i Komisionit	<b>Muhamet Morina,</b> Zyrtar i lartë i fushës
<b>Adem HODZA</b> Zëvendëskryetar i dytë i Komisionit	<b>Besim Haliti,</b> Zyrtar i lartë i fushës
<b>Dardan MOLLIQAJ</b> Anëtar i Komisionit	<b>Veton Raci,</b> Zyrtar i fushës
<b>Qëndron KASTRATI</b> Anëtar i Komisionit	<b>Nurie Morina,</b> Nëpunëse administrative
<b>Hykmete BAJRAMI</b> Anëtare e Komisionit	
<b>Mimoza KUSARI-LILA</b> Anëtare i Komisionit	
<b>Memli KRASNIQI</b> Anëtar i Komisionit	
<b>Gani DRESHAJ</b> Anëtar i Komisionit	
<b>Bilall SHERIFI</b> Anëtar i Komisionit	
<b>Duda BALJE</b> Anëtare e Komisionit	

## **Objektivat e përgjithshme**

**Nxitja e aktiviteteve në rrafshin institucional në kompletimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore, zbatimin e ligjit dhe inicimin e masave dhe politikave; monitorimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve qeverisëse dhe rregullatorëve të pavarur për të përmirësuar mjedisin biznesor, nxitjen e investimeve të huaja, rritjen ekonomike dhe përsosur asetet e Ndërmarrjeve Publike në interesin më të mirë publik.**

Për të arritur këto objektiva Komisioni në bazë të mandatit të tij brenda këtij viti do të angazhohet në aktivitetet si:

- Shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjeve;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjeve;
- Shqyrtimin e raporteve dhe monitorimin e punës së Agjencioneve të Pavarura;
- Shqyrtimin dhe monitorimin e Politikave të Ministrive përkatëse;
- Vizitë në terren për njohje me punën e Ministrive, Agjencioneve të Pavarura dhe Ndërmarrjeve Publike;
- Vizitë në terren për monitorimin e realizimit të politikave dhe projekteve;
- Vizitë zyrtare Parlamentit Evropian dhe Komisioneve homologe etj.

## **Rregulla për organizimin e brendshëm**

Më poshtë janë të listuara rregullat e përgjithshme për organizimin e brendshëm të Komisionit:

- Komisioni ndërtohet dhe funksionon në bazë të rregullores së Kuvendit;
- Dispozitat që rregullojnë kryesimin e Kuvendit janë bazë edhe për kryesimin e Komisionit;
- Komisioni ka Kryetarin dhe dy nënkryetarë;
- Komisioni ka stafin koordinues (Njësinë mbështetëse);
- Komisioni me dy të tretat e votave, mund të krijojë një ose dy nën-komisione;
- Komisioni për punë apo fusha të caktuara mund të krijojë grupe punuese;
- Nën-komisionet dhe grupet punuese i raportojnë Komisionit;
- Komisioni mund të caktojë anëtarët e tij si raportues për një çështje ose fushë të caktuar;
- Mbledhjet e Komisionit i thirr dhe i kryeson kryetari, ose në mungesë të tij zëvendëskryetari;
- Mbledhjen e Komisionit mund ta thërrasin edhe një e treta e anëtarëve të Komisionit;
- Komisioni vendos me konsensus ose me shumicë votash;
- Deputeti që nuk pajtohet me qëndrimin e shumicës ka të drejtë t'i bashkëngjisë qëndrimin e vet raportit të Komisionit;
- Mbledhjet e Komisionit janë të hapura, përpos kur Komisioni vendos ndryshe;

- Në mbledhje të komisionit mund të ftohen dhe të marrin pjesë përfaqësues të Qeverisë, përkatësisht ministrisë përkatëse, përfaqësues të institucioneve dhe asociacioneve të interesuara vendore e ndërkombëtare;
- Në punën e Komisionit mund të angazhohen edhe këshilltarë ekspert, në pajtim me udhëzimet procedurale e financiare
- Komisioni në punën e tij mund të shfrytëzojë edhe ndihmën e ekspertëve, institucioneve dhe asociacioneve ndërkombëtare.

## **Organizimi i brendshëm i Komisionit**

### **Kryetari**

Drejton dhe koordinon punën e gjithëmbarshme të Komisionit në bashkëpunim me zëvendëskryetarët;  
 Përfaqëson Komisionin, vetëm ose së bashku me zëvendëskryetarët dhe anëtarët e komisionit, varësisht nga natyra e përfaqësimit;  
 Raporton para Kuvendit për punën e Komisionit dhe paraqet qëndrimet e Komisionit;  
 Për çështje të caktuara mund ta autorizojë zëvendëskryetarët ose anëtarët raportues që të paraqesin qëndrimet e Komisionit.

### **Zëvendëskryetarët**

Ndihmojnë kryetarin e Komisionit dhe e zëvendësojnë atë, kur ai mungon;  
 Në marrëveshje me Kryetarin e Komisionit mbikëqyrin punën e grupeve punuese ose anëtarëve raportues për çështje ose fusha të caktuara, sipas vendimit të Komisionit;  
 Në marrëveshje me Kryetarin e Komisionit paraqesin qëndrimet e Komisionit para Kuvendit;  
 Mbikëqyrin zbatimin e Planit të Punës së Komisionit dhe raportojnë në komision çdo tre muaj;

### **Raportuesi**

Anëtarët e komisionit mund të angazhohen për të raportuar për një çështje të caktuar, apo për të mbuluar dhe hulumtuar një fushë të caktuar dhe për t'i raportuar lidhur me të Komisionit;  
 Me pëlqim të Komisionit dhe Kryetarit të tij, raportuesi mund t'i paraqesë qëndrimet e Komisionit edhe para Kuvendit.

## Plani i punës i Komisionit për 2018

<b>Periudha</b>	<b>Agjenda e Komisionit</b>	<b>Detyrat e Komisionit</b>
<b>Janar</b>	Hartimi i Planit të punës së Komisionit për 2018.	Komisioni/Njësia mbështetëse harton Planin e punës.
<b>Janar</b>	Projektligji për Standardizim.	Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Janar</b>	Projektligji për shoqëritë tregtare.	Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Janar</b>	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për energjinë elektrike.	Komisioni realizon aktivitete mbikëqyrëse.
<b>Janar</b>	Raportim i Ministrit të Infrastrukturës lidhur me pretendimet e Bechtel – Enka, për penalet që kanë derivuar nga mospërmbushja e detyrimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në ndërtimin e Autostradës “Arbën Xhaferi”.	Komisioni fton ministrin në raportim.
<b>Shkurt</b>	Raportim i Ministrit të Zhvillimit rajonal për prioritetet për vitin 2018.	Komisioni fton ministrin në raportim.

<b>Shkurt</b>	Mbikqyrja e zbatimit të kontratave të Kosovës me operatorë dhe qasja e Komisionit në këto kontrata brenda tre muajve.	Komisioni fton udhëheqësit e institucioneve përgjegjëse për raportim.
<b>Shkurt</b>	Shqyrtimi i Raportit të performancës së ndërmarrjeve Publike për 2015 dhe 2016.	Komisioni/Shqyrton dhe Rekomandon.
<b>Shkurt</b>	Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit.	Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Shkurt</b>	Projektligji për Pajisjet nën Presion.	Komisioni/Amendamentin dhe Rekomandim.
<b>Shkurt</b>	Vizitë mbikëqyrëse institucioneve të pavarura: - KPMM; - AKP; - AKK.	Komisioni njihet nga afër me punën e institucioneve të pavarura.
<b>Shkurt</b>	Projektligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.	Komisioni/Amendamentin dhe Rekomandim.
<b>Shkurt</b>	Projektligji për miniera dhe minerale.	Komisioni/Amendamentin dhe Rekomandim.
<b>Mars</b>	Projektligji për masat mbrojtëse në importe.	Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Mars</b>	Projektligji për Shërbimet Postare.	Komisioni/Amendamentin dhe Rekomandim.

<b>Mars</b>	Projektligji për produkte të ndërtimit.	Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Mars</b>	Projektligji për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.	Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Mars</b>	Projektligji për metrologji.	Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Mars</b>	Vizitë mbikëqyrëse institucioneve të pavarura: - KOSTT; - ARKEP.	Komisioni njihet nga afër me punën e institucioneve të pavarura.
<b>Mars</b>	Vizitë e Komisionit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë – Komisionit homolog.	Komisioni/Njësia mbështetëse.
<b>Prill</b>	Projektligji për ratifikimin a marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014-2020).	Komisioni/Shqyrton dhe Rekomandon.
<b>Prill</b>	Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institucioneve të pavarura: - ARH-së; - AAC-së; - ZRRE-së; - AKP-së.	Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.
<b>Prill</b>	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.	Komisioni/Amendamentin dhe Rekomandim.



	04/L- 016 për Eficiencën e Energjisë.	
<b>Prill</b>	Vizitë bizneseve – Sektorit prodhues eksportues.	Takime direkte me biznese për t’u njohur nga afër me zhvillimet, kërkesat dhe sfidat e bizneseve.
<b>Prill</b>	Tryezë për investimet strategjike.	Tryezë tematike nga fushëveprimtaria e Komisionit.
<b>Maj</b>	Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institucioneve të pavarura: - KPMM-së; - AKK-së.	Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.
<b>Qershor</b>	Vizitë Ndërmarrjeve Publike Qendrore.	Komisioni njihet nga afër me punën e ndërmarrjeve publike.
<b>Qershor</b>	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 179 për Transport Rrugor.	Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Qershor</b>	Vizitë bizneseve – Sektorit të tekstilit.	Takime direkte me biznese për t’u njohur nga afër me zhvillimet, kërkesat dhe sfidat e bizneseve.
<b>Qershor</b>	Tryezë për zhvillimin e turizmit.	Tryezë tematike nga fushëveprimtaria e Komisionit.
<b>Korrik</b>	Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institucioneve të	Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.

	pavarura: - KOSTT-it; - ARKEP-it.	
<b>Korrik</b>	Projektligji për Ndërmarrjet Publike.	Komisioni/Amendamentin dhe Rekomandim.
<b>Korrik</b>	Projektligji për tregtinë me naftë dhe produkte të naftës në Kosovë.	Komisioni/Amendamentin dhe Rekomandim.
<b>Korrik</b>	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-159 për Zonat Ekonomike.	Komisioni/Amendamentin dhe Rekomandim.
<b>Gusht</b>	///	///
<b>Shtator</b>	Vizitë mbikëqyrëse institucioneve të pavarura: - ZRRE; - AAC.	Komisioni njihet nga afër me punën e institucioneve të pavarura.
<b>Shtator</b>	Vizitë Ndërmarrjeve Publike Qendrore.	Komisioni njihet nga afër me punën e ndërmarrjeve publike.
<b>Tetor</b>	Vizitë bizneseve – Sektorit të industrisë së çelikut dhe plastikës.	Takime direkte me biznese për t'u njohur nga afër me zhvillimet, kërkesat dhe sfidat e bizneseve.
<b>Tetor</b>	Tryezë për zhvillimin e sektorit mineral.	Tryezë tematike nga fushëveprimtaria e Komisionit.

<b>Tetor</b>	Vizitë mbikëqyrëse institucioneve të pavarura: - ARH; - ARKEP.	Komisioni njihet nga afër me punën e institucioneve të pavarura.
<b>Nëntor</b>	Realizimi i projekteve të vitit 2017 dhe prioritetet për vitin 2018 - Ministrive të linjës dhe Agjencioneve të pavarura.	Komisioni fton ministrat dhe bordet në seancë dëgjimore.
<b>Dhjetor</b>	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L – 120 për Rrugët.	Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Dhjetor</b>	Projektligji për rezervat e obligueshme të naftës.	Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Dhjetor</b>	Shqyrtimi i projektbuxhetit për vitin 2017 të Ministrive të linjës dhe Institucioneve të pavarura.	Komisioni mban dëgjim me Ministrinë e linjës dhe Agjencionet e pavarura.

Përgatitur nga:  
Njësia mbështetëse e Komisionit  
23/01/2018  
Prishtinë

Kryetare e Komisionit  
Sala Berisha-Shala